



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

01-807

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-73614/21 dt. 23.04.2021, të pronarit Nuhi Sekiraqa, Sanije Sekiraqa, dhe Isa Sekiraqa nga Prishtina dhe investitorit N.T.N “Nardi”, dhe “Alko Impex” General Konstruktion shpk, me seli në Prishtinë, në rr. “Ndue Përlleshi pn., me certifikate të biznesit ARBK 810822272, dhe me pronarë Imer Ademi nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht, Ndërtesa “1” dhe “2”, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, në rr. “Abaz Ermenji”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 11.10.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Nuhi Sekiraqa, Sanije Sekiraqa, dhe Isa Sekiraqa nga Prishtina, me investitor N.T.N “Nardi”, dhe “Alko Impex” General Konstruktion shpk, me seli në Prishtinë, në rr. “Ndue Përlleshi pn., me certifikate të biznesit ARBK 810822272, dhe me pronarë Imer Ademi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-73614/21 dt.23.04.2021, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “1” dhe “2”, me etazhitet 2B+P+6, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-9527 dt. 08.04.2013, e lëshuar nga kjo Drejtori, në kuadër të bllokut urban “A18 dhe A19” të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 1569-0, dhe 1570-0, ZK Matiçan.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Abaz Ermenji” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 26, 28, 30 dhe 32, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-9527 dt. 08.04.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës, nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj certifikate.

IV. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

A r s y e t i m

Aplikuesit/pronarët Nuhi Sekiraqa, Sanije Sekiraqa, dhe Isa Sekiraqa nga Prishtina, me investitor N.T.N “Nardi”, dhe “Alko Impex” General Konstruktion shpk, me seli në Prishtinë, në rr. “Ndue Përlleshi pn., me certifikate të biznesit ARBK 810822272, dhe me pronarë Imer Ademi nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-73614/21 dt.23.04.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “1” dhe “2”, me etazhitet

2B+P+6, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "A18 dhe A19" të tërësisë urbane "A" të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1569-0, dhe 1570-0, ZK Matiçan, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-9527 dt. 08.04.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Aplikuesit me kërkesën, 05 Nr. 391/02-73614/21, të datës 23.04.2021, 05 Nr. 391/02-243231/22 të datës 04.11.2022 dhe 05 Nr. 391/02-7974/23 të datës 12.01.2023, kanë prezantuar:

- Aktvendimin me numër 05 Nr. 351-9527 dt. 08.04.2013, për Lejimin e Ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa "1" dhe "2", me etazhitet 2B+P+6, të pronarëve Nuhi Sekiraqa, Sanije Sekiraqa, dhe Isa Sekiraqa nga Prishtina, sipas dëshmisë së pronësisë nga Prishtina, me investitor N.T.N "Nardi", dhe "Alko Impex" General Konstruktion shpk, me seli në Prishtinë, në rr. "Ndue Përlleshi pn., me certifikate të biznesit ARBK 810822272, dhe me pronarë Imer Ademi nga Prishtina në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 1569-0, dhe 1570-0, ZK Matiçan.
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtoria sipas Vendimit me numër 05-391/02-73614/21 të datës 16.11.2022.
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e komisionit për pranim teknik, ka konstatuar se:

Ndërsa, në raportin e komisionit profesional për pranimin teknik të ndërtesës është konstatuar se pranohet si objekt funksional, teknikisht i rregulluar, me siguri në stabilitet dhe performancë të shkëlqyer;

- Sipas nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, dhe dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110 janë plotësuar organi kompetent lëshon certifikatën të përdorimit brenda kohës së caktuar;

Andaj, kjo drejtori, duke u bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe duke vepruar konform nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat ligjore të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, si dhe në raportin e komisionit për pranim teknik, konstatoi se ndërtesat shumë banesore me afarizëm me etazhitet 2B+P+6, mund të përdoren, përkatësisht vendosi të lëshojë Certifikatën e Përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate


Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-73614/21 DT. 11.10.2024

Zyrtari,
Bahtije Vllasaliu



Udhëheqëse e sektorit,
Nazife Krasniqi

